

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit

Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative

me profile Administratë Publike, Qeverisje vendore, Politika sociale.

Ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Klodiana Beshku (Ph. D)

Klementin Mile (Ph. D)



Gusht 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për vlerësimin periorik të programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike dhe

Administrative

me profile Administratë Publike, Qeverisje vendore dhe Politika sociale.

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Fakulteti që e ofron	*Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMAS Nr 482, datë 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	VKA nr. 334, datë 08.06.2012 Urdhër nr. 291, datë 11.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profile: ii. Administratë publike ii. Qeverisje vendore iii. Politikat Sociale
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	** 1 nga 1,5 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	**60 nga 90 kredite të parashikuara
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve	26 studentë
	Etj	

*Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike nuk është i akredituar. Rregullorja e këtij Fakulteti është miratuar më 12.06.2017.

** Sipas UMASH Nr 482, datë 03.10.2011, Programi i studimit do të realizohet me 90 kredite dhe kohëzgjatje normale 1.5 vite, por aktualisht rezulton me 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit.

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në “Shkenca politike dhe administrative” me profile: i. Administratë publike, ii. Qeverisje vendore; iii. Politika sociale.

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca politike dhe administrative” me profile: i. Politikat sociale; ii. Administratë publike; iii. Qeverisje vendore është licensuar me UMASH Nr 482, datë 03.10.2011 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programeve të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Shkollën e Lartë Private “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, mbështetur në VKA Nr 256, datë 16.09.2011

Programi i studimit Master profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative” me profile: i. Politika sociale; ii. Administratë publike; iii. Qeverisje vendore, është akredituar për herë të parë me UMASH Nr 291, datë 11.07.2012 “Për akreditimin e disa programeve të studimit të ciklit të dytë të Institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë””, mbështetur në VKA Nr 334, datë 08.06.2012. Vlen të theksohet që në këtë Urdhër mungon emërtimi i programit të studimit. Këtu janë dhënë vetëm profilet: i. Politika Sociale; ii. Administratë Publike; iii. Qeverisje Vendore. Duke qenë se Urdhëri i MASH është mbështetur në VKA, emërtimi i programit është sipas VKA Nr 334, datë 08.06.2012: Master profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profile: Politika sociale; Administratë publike; Qeverisje vendore

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për këtë program studimi, GVJ është hasur me disa emërtime të ndryshme të tij. Konkretisht:

- Ky program, nga Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative” me profile: a. Politika Sociale; b. Administratë Publike dhe c. Qeverisje Vendore, është riorganizuar me shkresë nga Sekretari i Përgjithshëm i MASR nr. 2749/1 prot dt. 24.04.2018 në: Master profesional në “Shkenca Politike” me profile:
 - i. Administratë Publike
 - ii. Qeverisje vendore
 - iii. Politikat sociale

Ky riorganizim është bërë pasi është përcjellë në ASCAL, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm nga UMSH.

- Në RVB-në e Marsit 2018, emërtimi është herë “Master Profesional në Shkenca Politike” me profile (Kopertina) dhe herë “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative” me profile (në faqet e brendshme). Edhe në kërkesën e fundit të paraqitur për Akreditim nga UMSH, Nr. 301/1 Prot., i datës 10.04.2018, “Dërgohen Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe dosjet e akreditimit në kuadër të akreditimit dhe riakreditimit të 12 programeve të studimit në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë””, emërtimi është “Master Profesional në Shkenca Politike”.
- Referuar Vendimit të Senatit Akademik Nr. 6/1, dt. 19.05.2017, emërtimi i këtij programi është Master profesional në Shkenca Politike me profile.

Ky emërtim në të gjithë rastet më sipër, nuk është i saktë.

Emërtimi përfundimtar që do të përdoret tani e tutje në këtë RVJ, ku profili “Politikat sociale” do të përdoret në trajtën e pashquar, si dy të tjerët, pra bëhet “Politika Sociale”, do të jetë i njëjtë me emërtimin që ka programi i studimit në:

- I. Urdhërin e akreditimit të parë të MASH, Nr 291, datë 11.07.2012.
- II. Në Formatin e Diplomës dhe Supplementit rezulton emërtimi: **Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative” me profile: a. Politika Sociale; b. Administratë Publike; c. Qeverisje Vendore**

Referuar Urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (UMSH) Nr 482, datë 03.10.2011 "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë 'Bachelor', programeve të ciklit të dytë 'Master professional' dhe programeve të studimit të ciklit të dytë 'Master i shkencave', në Shkollën e Lartë Private 'Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë'", programi i studimit Master profesional në "Shkenca politike dhe administrative" me profile: i. Politika sociale; ii. Administratë publike; iii. Qeverisje vendore, do të realizohet me 90 kredite dhe kohëzgjatje normale 1.5 vite. Ndërkohë që, në Vendimin e UMSH-së, të datës 03.01.2017, Për planin Mësimor të këtij Programi për vitin akademik 2017-2018 (Aneksi nr. 4 në sistem), programi në fjalë rezulton me 60 kredite.

Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ nuk kishte ndonjë material se si është organizuar ky program studimi nga 90 kredite/1.5 vite akademike në 60 kredite/1 vit akademik

Programi është organizuar në lëndë mësimore të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Tranferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Rezulton se Profili "Studime sociale" nuk rezulton i ndarë plotësisht prej Qeverisjes lokale. GVJ rekomandon të kryhet një ndarje e qartë e këtyre dy profileve përsa i përket planit mësimor që ata ofrojnë.

Ky program është në proces riakreditimi, duke qenë se është akredituar më parë në periudhën 13.01.2012/29.03.2012 me VKA Nr. 334 datë 08.06.2012 dhe Urdhër i MAS Nr. 291, datë 11.07.2012. Ky riakreditim bazohet në Raportin e vlerësimit të brendshëm të ekspertëve të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" të Marsit 2018, në dokumentacionin shtesë të përcjellë nga ky institucion, por edhe në vizitën në Institucion. Programi është në përputhje me dispozitat e MAS dhe ASCAL e me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Me Urdhërin nr. 273, dt. 18.05. 2017 të MAS, mbi bazën e kërkesës së Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është miratuar hapja e njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Politike, Sociale dhe Psikologjike dhe Riorganizimi i njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike në Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Si rrjedhojë, UMSH-ja përbëhet nga:

- a) Fakulteti i Shkencave Ekonomike
- b) Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- c) Fakulteti i Shkencave Politike, Sociale dhe Psikologjike.

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstaton se: në RVB-në Mars 2018 nuk del qartë nëse ky Program Masteri Profesional zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Politike, Sociale dhe Psikologjike apo në atë të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Aty ky Master radhitet si pjesë e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (fq. 6, paragrafi 4), ndërkohë që më pas RVB-ja bën një detajim të Fakultetit të Shkencave Politike, Sociale dhe Psikologjike. Gjithashtu, edhe tabela bazë tek e cila shënohen të dhënat kryesore të Programit, në RVB (fq. 9-10) nuk është e plotë. Më pas, në RVB (fq. 16) cilësohet se ky Program është pjesë e Kurrikulës së Fakultetit të Shkencave Politike, Sociale dhe Psikologjike.

Ky Fakultet ka tre Departamente:

1. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë
2. Departamenti i Shkencave Politike
3. Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit bazë.

Në dokumentin e hapjes, UMASH Nr. 482, datë 03.10.2011, me emërtimin pika 1.a) "Shkenca politike dhe administrative", me profile: i. "Politika Sociale"; ii. "Administratë publike"; iii. "Qeverisje vendore", dhe pika 5, programi realizohet me 90 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është 1.5 vite akademike. Në realitet, Masteri ka 60 kredite dhe zhvillohet në 1 vit sipas Planit Mësimor për vitin 2017-2018 të dërguar në Sistem (Aneksi 4). Gjatë vizitës në Institucion, në takimin që realizoi

GVJ me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit, nga këta drejtues ju komunikua GVJ se programi i studimit në fillim është ofruar me 90 kredite/1.5 vite, ndërsa pas vitit 2015 u strukturua në 60 kredite/1 vit.

Me VS nr.6/1, datë 2017-05-19 programi kalon nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku profili a. Politika Sociale ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike; kurse profilet b. Administratë Publike; c. Qeverisje Vendore ofrohen nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë.

Në realitet: Masteri Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative zhvillohet kryesisht nga Departamenti i Shkencave Politike, sipas vendimit UMSH i dt, 3/10/2017 për miratimin e Planit Mësimor të Masterit, të paraqitur nga vetë IAL-ja në sistem.

Sipas këtij vendimi: Departamenti i cili rezulton edhe përgjegjës për këto Plane Mësimore është Departamenti i Shkencave Politike.

Referuar edhe RVB, faqe 21, Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Politike dhe Administrative. Ndërsa në faqen nr 20 po të RVB emërtimi i këtij Departamenti paraqitet Departamenti i Shkencave Politike.

Edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ realizoi takimin me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike Prof As Përparim Kabo dhe Shefin e Departamentit të Shkencave Politike DR. Skënder Demaliaj.

Në Departamentin e Shkencave Politike japin mësim 5 (pesë) Personel akademik Efektiv/me kohë të plotë (PAE) në këtë Master, ndërkohë që janë edhe 2 (dy) PAE nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë dhe 1 (një) nga ai të drejtës Penale. Nuk ka asnjë PAE nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit bazë nga i cili mendohet të zhvillohen dy prej profileve të këtij Masteri.

Aktualisht programi, për vitin akademik 2017-2018, ka 26 studentë të regjistruar nga të cilët 7 janë me bursë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Klodiana Beshku (Ph. D)
2. Klementin Mile (Ph. D)

Menaxhere vlerësimi e ndjekjes së procedurës së këtij programi është Specialistja e ASCAL Znj Suela Kromidha. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u shoqërua nga Specialistja e ASCAL Znj Xhiliola Bixheku Më datë 20.07.2018 është dërguar nëpërmjet sistemit AMS Draft RVJ në Institucion. Me datë 01.08.2018, po nëpërmjet sistemit vijnë nga UMSH objeksionet në lidhje me këtë Draft. Pasi GVJ u njoh me këto objeksione, vendosi që të pranojë sqarimin vetëm për ndryshimin e numrit të studentëve nga 23 në 26 studentë të regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2017-2018. Në këtë mënyrë Draft raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit sipas VKA Nr 334, dt 08.06.12.

I. Për programin e studimit “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative, me profil: Politika sociale”.

- a. Institucioni duhet të forcojë programet studimore në përputhje me kërkesat e tregut.



- b. Institucioni duhet të angazhojë personel akademik të mjaftueshëm për përmbushjen e misionit të tij.
- c. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Për programin e studimit “Master profesional në Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike”

- a. Të shikohet në të ardhmen mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë
- b. Të realizohet përmirësimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë;
- c. Të bëhet shumë promovim për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera në fushën e administratës publike
- d. Të shihet mundësia që në semestrin e dytë të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore
- e. Të hartohet një plan të përgjithshëm strategjik 10-20 vjeçar, dhe i detajuar në periudha afatmesme e afatshkurtëra për zhvillimin e institucionit dhe për të parashikuar ndryshimet e ndryshme që mund të ndoshin e për ti bërë ballë konkurrencës së vazhdueshmë nga universitetet e tjera të vendit qofshin këto publike apo private.
- f. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

III. Për programin e studimit “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative, me profil: Qeverisje vendore”.

- a. Të punohet për thithjen e një kontigjenti të mjaftueshëm studentësh për realizimin me sukses të programit.
- b. Të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe të konsolidohen departmentet, qendra e vlerësimit të brendshëm, zyra e karrierës, etj.
- c. Të punohet më shumë për aplikimin e metodave të vlerësimit për tërheqjen e organizuar të vlerësimit të programeve nga vetë studentët. Kontrolli i cilësisë duhet të kryhet në mënyrë sistematike për programin e studimit.
- d. Të plotësohen regjistrat dhe të instalohet një program për mbajtjen e të dhënave në sekretari.
- e. Të punohet për rritjen e vizibilitetit të Institucionit në tregun përkatës, për të rritur mundësitë për tërheqjen e studentëve me cilësorë dhe për krijimin e mundësisë për rivendosjen e kritereve përzgjedhëse.
- f. Të përditësohet dhe rritet informacioni për planet mësimore, të gjitha modulet, dhe aktivitetin shkencor. Faqja e internetit duhet të përditësohet dhe të japë më shumë informacion në lidhje me programet e studimit.
- g. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

IV. Plotësimi i tyre nga Institucioni

I. Për programin e studimit “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative, me profil: Politika sociale”.

- a) Për rekomandimin a, Institucioni i ka realizuar programet mësimore në përputhje me nevojat e tregut.
- b) Institucioni ka plotësuar numrin e pedagogëve me grada/tituj në raportin mbi 50%. Vërehet se tashmë në Planin Mësimor të vitit akademik 2017-2018, në ndryshim nga vitet e mëparshme, programi ka vetëm PAE dhe asnjë PAK. Rekomandohet të vendosen të paktën një ose dy PAK, specialistë në fushat specifike që mbulon ky Master, pra të punësuar në Administratën Publike, në mënyrë që ata të transmetojnë përvojën e tyre.

- c) IAL-ja rezulton të ketë kryer një marrëveshje me STA (TOEIC) në lidhje me këtë çështje

II. Për programin e studimit “Master profesional në Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike”

- a) Është rritur numri i pedagogëve me kohë të plotë me grada e tituj shkencorë
- b) Është realizuar përmirësimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë.
- c) Ka pasur përpjekje për të realizuar më shumë promocion për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor. Ky promocion është arritur nëpërmjet bursave të plota e të pjesshme, por edhe nëpërmjet punës së IAL-së ndaj këtij programi
- d) Nuk ka ende lëndë me zgjedhje në këtë program.
- e) IAL-ja ka miratuar Strategjinë afatgjatë në lidhje me këtë pikë, të miratuar nga Bordi i QM
- f) Në lidhje me këtë pikë, institucioni ka kryer një marrëveshje me STA (TOEIC).

III. Për programin e studimit “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative, me profil: Qeverisje vendore”.

- a) IAL-ja rezulton të ketë punuar shumë në këtë drejtim. Është bërë lidhja e duhur me kërkesat që vijnë nga të punësuarit në Administratën publike dhe janë dhënë edhe bursa të pjesshme ose të plota për studentët në nevojë.
- b) Institucioni ka plotësuar numrin e pedagogëve me grada/tituj në raportin mbi 50% dhe i ka konsoliduar këto njësi. Njësia e Sigurimit të Kontrollit të Cilësisë funksionon rregullisht e me efikasitet.
- c) NJSBC-ja dhe NJSBCZHK-ja të cilat merren kryesisht me kontrollin e vlerësimit të brendshëm, funksionojnë normalisht.
- d) Regjistrat u gjetën pjesërisht në rregull. Studentët regjistroheshin direkt në profilin e dëshiruar. Nuk ekzistonte një regjistër i veçantë për profilin Qeverisje vendore. Ai profil qendronte së bashku me Administrimin publik. Regjistrat duhet të përditësohen në mënyrë më rigoroze.
- e) Për rekomandimin h, institucioni është impenjuar në mënyrë të konsiderueshme. Këtë e dëshmon edhe rritja e theksuar e numrit të studentëve në këto dy vitet e fundit akademikë.
- f) Informacioni për Planet mësimore është ende jo i plotë. Profili Administratë publike dhe Qeverisje vendore rezulton të jenë të njëjtë. Planet mësimore janë të papërditësuara, ato janë ende me 60 kreditë në vend që të jenë me 90 sipas venimeve më të fundit. IAL-ja ka shtuar 2 lëndë me zgjedhje në programin në fjalë. Rekomandohet të rritet numri i tyre dhe të jenë lëndë specifike për secilin nga profilet, jo kaq të përgjithshme e për të treja profilet të njëjtat lëndë. Institucioni e përditëson vazhdimisht platformën e tij online në web-in: www.umsh.edu.al.
- g) IAL-ja rezulton të ketë kryer një marrëveshje me STA (TOEIC) në lidhje me këtë çështje. Kjo pikë është rregulluar nëpërmjet akteve ligjore dhe udhëzimeve të MASR.

Gjatë shyrimit të dokumentacionit përkatës dhe vizitës në institucion, u konstatua plotësimi i pothuajse të gjithë rekomandimeve kryesore të shpallura nga akreditimi i parë.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimor

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profil: i. Politika Sociale; ii. Administratë Publike, iii. Qeverisje vendore, është akredituar për herë të parë me VKA nr. 334, datë 08.06.2012 dhe Urdhër nr. 291, datë 11.07.2012. Aktualisht ky program është në proces riakreditimi. Ky program studimi është një program i cili i përgjigjet kërkesave në rritje për këtë degë nga ana e studentëve të rinj si edhe të punësuarve në administratën publike apo aspirantëve si të tillë.

Si rrjedhojë, misioni/objektivat e këtij programi studimi janë në funksion të përgatitjes praktike dhe teorike të studentit/nëpunësit civil, të përshtatura me kohën dhe nevojat aktuale të tyre dhe të momentumit që po kalon administrata publike si pasojë e reformimeve të vazhdueshme të saj.

Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të këtij Masteri, Rregulloren e Programit të studimit, Rregulloren e UMSH-së dhe Manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, mund të thuhet se: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata janë në funksion të IAL-së, studentëve/aspirantë-studentëve të tij si edhe prioriteve kombëtare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programi i këtij Masteri profesional është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi në fjalë i studimit është dëshmi e rritjes institucionale dhe e kërkesave të Institucionit. Në përputhje me specifikimin e Statusit të nëpunësit civil dhe nevojave në rritje të Administratës Publike, ky program duket se i ka reflektuar më së miri këto dinamika, pra nevojat e tregut të punës, nevojën për plotësimin e kriterëve për të ruajtur/marrë statusin e nëpunësit civil së bashku me zhvillimin ekonomik të vendit dhe reformës në administratën publike. Objektivat, formimi dhe kompetencat profesionale të studentit janë të qarta si në RVB ashtu edhe në Rregulloren dhe Statutin e këtij programi.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi i këtij Masteri profesional është përshtatur me Strategjinë e afatgjatë e afatmesme të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë". Përveç kësaj, programi është integruar tërësisht me Strategjinë e Kërkimit shkencor të institucionit, rekomandimet e akreditimit të parë dhe motos së institucionit 'studenti në qendër'. Si rrjedhojë, është synuar zgjerimi por edhe ruajtja e cilësisë dhe

	<p>formimi bazik i studentit si punonjës i ardhshëm i administratës publike.</p> <p>Dallohet qartë një konceptim i personalizuar i programeve për secilin prej profileve. Ai në Administratë publike është i përqendruar në formimin e nënpunësit të administratës qendrore, ai në Qeverisje vendore në formësimin e një punonjësi të denjë të nivelit të Qeverisjes lokale, ndërkohë që profili në Politika sociale duhet të specifikohet e të diversifikohej prej Qeverisjes lokale, pasi rezultojnë të ngjashëm përsa i përket planit mësimor.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Duket se për hartimin e këtij program, grupi i punës i Universitetit Mesdhetar Shqiptar është bazuar, në mënyrë rigoroze mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Strategjinë Kombëtare b. Përshatjen e administratës publike me atë të BE-së c. Reformën mbi Administratën Publike (2015-2019) d. Ligjin për arsimin e lartë e. Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit f. Politika e zhvillimit të studimeve Master g. Statuti i brendshëm dhe rregullorja h. Kërkesat e tregut <p>Emërtimi përfundimtar që do të përdoret tani e tutje në këtë RVJ, ku profili “Politikat sociale” do të përdoret në trajtën e pashquar, si dy të tjerët, pra bëhet “Politika Sociale”, do të jetë i njëjtë me emërtimin që ka pasur ky program studimi në Urdhërin e akreditimit të parë të MASH, Nr 291, datë 11.07.2012.</p> <p>Referuar Vendimit Nr 334, datë 08.06.2012 të KA, emërtimi i këtij programi studimi është:</p> <p>Master profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative” me profile:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Politika Sociale ii. Administratë Publike iii. Qeverisje vendore
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit në fjalë është krijuar pas një hulumtimi të kujdesshëm mbi hapësirat e lëna prej përthithjes së studentëve nga tregu i punës.</p> <p>Ndonëse nuk ka një studim të mirëfilltë në këtë drejtim, grupi i punës për rifreskimin e këtij programi, duket dhe pohon se është bazuar mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Kërkesat e studentëve të diplomuar b. Kërkesat e të punësuarve në Administratën publike dhe nevojës së tyre për të përmbushur kriteret me qëllim marrjen/ruajtjen e statusit të nënpunësit civil

c. Institucionet publike ato private në fushën e punës sociale.
Në këtë kuadër, programi në fjalë është parë si i domosdoshëm, sidomos pas forcimit të ligjit mbi Statusin e Nënpunësit civilë. Kjo ka sjellë një *boom* regjistrimesh në këtë program, për vitin 2017-2018.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Ndonëse mungon një studim i mirëfilltë i tregut, puna për këtë program, duket se është ndihmuar prej ligjit të fundit mbi Nënpunësit civil, reformës në administratën publike si edhe prej ndryshimit të statusit të IAL-së nga Shkollë e lartë në Universitet. Në këto kushte, një studim tregu në kuptimin e mirëfilltë të tij, nuk ka qenë i domosdoshëm. Programi është hartuar në përputhje me nevojat kombëtare, specifikat e kohës dhe kërkesës së jashtme.
2. Në kuadrin makro të plotësimit të standarteve, programi përputhet si me nevojat kombëtare e vlerat kulturore kombëtare, ashtu edhe me nevojat dhe parimet e IAL-së në fjalë e të Fakultetit përkatës.
3. Profili “Administratë Publike” nuk rezulton i ndarë plotësisht prej profilit të “Qeverisjes lokale”, si në planin mësimor, ashtu edhe në regjistra themeltarë. Rekomandohet të kryhet një ndarje e qartë e këtyre dy profileve përsa i përket planit mësimor që ata ofrojnë dhe regjistrimit të studentëve.
4. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike (FSHPSP), shpesh rezulton i përmendur si Fakulteti i Shkencave Politike në RVB. Masteri profesional në Shkenca Politike dhe Administrative ndonjëherë emërtohet vetëm Master profesional në Shkenca Politike. Sugjerohet të ruhet një standart në emërtimin e tij, sipas sqarimeve dhe analizës në hyrje të kësaj RVJ-je.

Standartet e përgjithshme konsiderohen të përmbushura kryesisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, aktualisht, është i strukturuar me tre Fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike dhe Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Programi Master profesional në Shkenca politike dhe Administrative me profile në Administratë publike, Qeverisje lokale dhe Politika Sociale është pjesë e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike (FSHPSP) të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Fakulteti synon të përgatisë psikologë, sociologë, politologë dhe specialistë/punonjës të Administratës publike. Gjithashtu, ai synon rritjen e cilësisë të kërkimit shkencor në fushat përkatëse. Ai ka në përbërje Personel të kualifikuar Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) si edhe personel administrativ. Baza e të dhënave të njësisë gjendet në:

- a. Zyrën e burimeve njerëzore
- b. Sekretarinë mësimore
- c. Njësinë bazë dhe atë kryesore

Përgjegjësia e mbajtjes dhe e dhënies së informacionit i përket drejtuesve të hallkave sa më sipër. Informacioni bazë është lehtësisht i deduktueshëm edhe në çeb-in e Universitetit: [ëëë.umsh.edu.al](http://eeë.umsh.edu.al).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Pas një riorganizimi të brendshëm në vitin 2017, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, tashmë, ka në përbërje tre Departamentë të cilët funksionojnë si njësi bazë:

1. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë
2. Departamenti i Shkencave Politike
3. Departamenti i Administrimit publik dhe Formimit bazë

Aktualisht, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ofron 3 programe në nivelin Bachelor; 3 programe studime në nivelin Master i shkencave, dhe 2 programe studime profesionale. Ai ka :

PAE: 24 (nga të cilët 14 janë me tituj/grada)

PAK: 9 (nga të cilët 5 me tituj/grada).

Referuar Vendimit të Senatit Akademik të UMSH NR 6/1, datë 19.05.2017, ky program studimi duhet të ofrohet në dy Departamente: Në Departamentin e Shkencave Politike ofrohet profili i Politikave Sociale ndërsa në Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë ofrohet profili Qeverisje vendore dhe Administratë publike.

Në praktikë, ndarja nuk është e qartë. Pedagogët që japin mësim në këtë Master janë kryesisht nga Departamenti i Shkencave Politike. Duhet fuqizuar e konsoliduar Departamenti I Administrimit publik dhe formimit Bazë.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Referuar Vendimit të Senatit Akademik të UMSH NR 6/1, datë 19.05.2017, ky program studimi ofrohet në dy Departamente. Në Departamentin e Shkencave Politike ofrohet programi Master profesional në Shkenca Politike me profil Politikave Sociale dhe në Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë ofrohet programi Master profesional në Shkenca Politike me profil Qeverisje vendore dhe Administratë Publike. (Shih Hyrjen e RVJ-së)

Referuar këtij Vendimi Senati, emërtimi i programit është gabim pasi jepet si Master profesional në Shkenca politike dhe jo Master profesional në Shkenca Politike dhe Administrative. (Shih Hyrjen e RVJ-së)

Referuar RVB, faqe 20, paragrafi i parë, shkruhet shprehimisht se *Departamenti i Shkencave Sociale dhe Administrative është përgjegjës për programin e studimit Master profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profile: Administratë Publike, Qeverisje Vendore, Politikave Sociale.*

Në anekset përkatëse të RVB-së së paraqitur (tabela 1 dhe 1.1), gjenden të dhënat e detajuara në lidhje me stafin akademik të Fakultetit si edhe të Departamentit përgjegjës, pra ai i Shkencave Politike dhe i Administrimit Publik e Formimit Bazë.

Në Departamentet në fjalë, aktualisht ka:

Departamenti Shkenca Politike:

PAE: 8 (nga të cilët 5 me gradë shkencore/tituj)

PAK: 3 (nga të cilët 1 me gradë shkencore/tituj)

Departamenti Administrim Publik dhe formimit bazë:

PAE: 7 (nga të cilët 3 me gradë shkencore)

PAK: 0

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Që prej akreditimit të parë, IAL-ja i ka zbatuar rekomandimet e këtij akreditimi, duke e rregulluar ndjeshëm raportin PAK/PAE, nëpërmjet kualifikimit të pedagogëve ekzistues. Dhe marrjes së atyre të rinj për këtë program. Institucioni ka kaluar në ekstrem tjetër, duke e çuar në 0 (zero) numrin aktual të PAK-të në këtë program.

Në këtë drejtim, gjendja e konstatuar në institucion reflekton një frymë të mirë bashkëpunimi mes drejtuesve të IAL-së dhe pedagogëve të brendshëm, në funksion të kualifikimit të këtyre të fundit, por ndërkohë vihet re se mungesa e Pedagogëve me kontratë ul nivelin e bashkëpunimit të këtij Programi me hallka të tjera të shoqërisë, si për shembull me Administratën Publike, prania në mësimdhënie e të punësuarve aty do të ishte një vlerë e shtuar për këtë Program Masteri Profesional.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>IAL-ja është i mirëorganizuar në funksion të përmbushjes së detyrës së tij.</p> <p>Ai ka tre fakultete.</p> <p>Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka të paktën 3 departamente. Fakulteti në fjalë ka tri të tilla.</p> <p>Çdo fakultet përbëhet nga të paktën 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të përcaktuar. Të gjitha këto mund të shihen fare qartë në statutin, Rregulloren dhe organigramën e IAL-së.</p> <p>Të dy departamentet në shyrtime kanë 8 dhe 7 anëtarë efektivë, kur minimalisht tre prej tyre janë me gradë shkencore.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve. Për këtë arsye ato i kanë forcuar procedurat e rekrutimit të pedagogëve, të vlerësimit të cilësisë dhe të shërbimit ndaj studentit.</p> <p>Departamentet janë të përfshirë në këtë proces nëpërmjet hartimit të nevojave të tyre të fundvitit përsa i përket personelit dhe janë pjesëmarrës në komisionet përkatëse.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none">1. IAL-ja i përmbush të gjitha standartet formale të përbërjes së tij.2. Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve.	
Standartet përmbushen	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Për tre vitet e fundit akademike, në këtë program studimi janë angazhuar:

- Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 9 anëtarë të personelit akademik, duke përbushur kriterin e raportit PAE/PAK, nga të cilët 3 Prof. As; 4 Phd; 1 Dr dhe 1 Msc. Ndërkohë nuk rezulton asnjë pedagog me kontratë në këtë program.
- Për vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 6 PAE, nga të cilët 2 Prof As; 1 Phd; 2 Phd në proces dhe 1 Msc. Ndërsa si PAK janë angazhuar 2 Prof. As.
- Në vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 6 PAE nga të cilët 2 Prof. As; 2 Phd në proces dhe 2 Msc

Gjatë shqyrtimit të dosjes së vetvlerësimit (DVV), vizitës në institucion dhe takimeve të realizuara gjatë kësaj vizite, rezulton se ka përputhshmëri të fushës së eksperimentit të pedagogut (të studimeve apo kualifikimeve të ndryshme ndër vite) me lëndët që ata mbulojnë në këtë program studimi.

Të dhënat më të detajuara gjenden në Anekse, tabela e stafit akademik në vite.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Pedagogët e këtij programi rezultojnë të punësuar në përputhje me:

- a. Ligjit të arsimit të lartë nr. 80/2015
- b. Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë
- c. Statutit dhe rregullores së UMSH-së.

Punonjësit akademikë të kategorisë Profesorë dhe Lektorë punësohen me kontratë me kohë të pacaktuar, ndërsa ata të kategorisë Asistent lektorë me kohë të përcaktuar.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë


Stafi administrativ ndihmës është i përzgjedhur me kujdes, sipas nevojave të Fakultetit/Departamentit dhe programit në fjalë. Ai është i kualifikuar dhe me eksperiencë. Kjo u dëshmuar edhe përgjatë të gjithë vizitës në institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik është angazhuar për arritjen e këtyre objektivave nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none">- Specializimeve të ndryshme- Njohjes me kornizën kurikulare të këtij masteri

	<ul style="list-style-type: none"> - Njohjen me kurrikulat e programeve homologe. - Konsultimeve me ekspertë të fushave të ndryshme. <p>Personeli ndihmës mësimor-shkencor i institucionit është i angazhuar plotësisht në funksion të stafit akademik dhe atij ndihmës, duke e mbështetur në IT, bibliotekë, evente etj.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik është autori kryesor i hartimit të kurrikulës. Kurrikula rishikohet nga përgjegjësi i njësisë bazë i cili jep sugjerime në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe literaturën.</p> <p>Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, Rregulloreve dhe Statutit të brendshëm të UMSH-së dhe nevojave të njësisë bazë.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Institucioni ndjek një procedurë ligjore transparente (thirrja publikohet fillimisht në ëeb-in e IAL-së) dhe kriteret për rekrutim hartohen në bazë të dispozitave ligjore si edhe kërkesave specifike të departamentit.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën mbi 70 % të personelit akademik të programit në fjalë. Duke qenë se në këtë program, për këtë vit akademik nuk ka PAK, atëherë PAE është 100%.</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore për rekrutimin e personelit. Pas një fazë të parë të mbledhjes së aplikimeve, kandidatët i nënshtrohen një konkursi të rregullt në IAL.</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore përgjegjëse për bazën e të dhënave disponon një bazë të kënaqshme të dhënash për të gjithë proceset e rekrutimeve të mëparshme.</p>
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit në fjalë ka titullin Doktor shkencash.</p> <p>Titullarët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose diplomën “Master Profesional” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi.</p> <p>Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit rezultojnë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Çdo student në këtë program Masteri profesional, ka të drejtën dhe detyrimin e kryerjes së një praktike profesionale. Kjo realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshjeve me institucionet e tjera. - Agjensisë Headhunter me të cilën Institucioni ka një bashkëpunim të ngushtë’. <p>Pedagogët e programit janë ata të cilët mikëqyrin këto praktika.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentët e këtij programi e kanë një udhëheqës për temën e diplomimit.</p> <p>Udhëheqësi e ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat përkatëse të shkencave Shoqërore që kanë lidhje me këtë Master.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL dhe takimeve të realizuar me Drejtuesit e Departamentit dhe të Fakultetit, na u komunikua se studenttë mund të mbrojnë temë diplomë në rast se kanë mesatare të lartë. Studentët që kanë mesatare më të ulët japin një provim formimi. Gjithashtu se GVJ ju komunikua se teza për provimin përfundimtar zë 30-40%, ku studentëve paraprakisht ju jepen një set pyetjesh dhe ju bëhej edhe seancë këshillimore ku orientoheshin në lidhje me këto pyetje. Nëse numri i studentëve ishte më shumë se 30, atëherë institucioni hartonte dy teza Gjithashtu GVJ ju komunikua se studentëve mund të mbrojnë temë në rastin kur kanë mesatare të lartë, ndërsa studentët që kanë mesatare më të ulët japin provim</p>



	formimi. Vetëm ata që siguronin një mesatare mbi 8 mund të bënin mbrojtjen e tezës.
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi rezulton në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. Kjo ndihmohet edhe nga karakteri shumëdisiplinor që ka fusha e studimit e Skencave Politike dhe administrative e këtij Masteri.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike, mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore, organizimin e konferencave, eventeve, “Panairit të ideve”, etj.</p> <p>Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Për më tepër, në institucion rezulton të realizohen të gjitha veprimtaritë që kanë lidhje me mësimdhënien në mënyrë rigorozë dhe me një seriozitet maksimal.</p> <p>Studentët janë të mbështetur nga një tutor/instruktor i cili i orienton dhe ndihmon në rrugëtimin e tyre, në raportin 1/10.</p> <p>Tutorati duket të jetë shumë efikas edhe në zbutjen e konflikteve mes studentëve dhe pedagogëve/stafit administrativ.</p> <p>Përveç këtyre, Zyrat e Informacionit dhe e Karrierës janë në funksion të plotë të nevojave të studentëve.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. Nga takimi i GVJ me zyrën e burimeve njerëzore, u komunikua së ngarkesa mësimore e stafit është 270 orë të pa konvertuara. U pohua se nuk ka pedagogë të cilët mbulojnë më shumë se 270 orë. Ndërsa për pedagogët të cilët angazhohen edhe me punë</p>

	<p>administrative, ngarkesa e tyre nuk shkon më shumë se 150 orë.</p> <p>Nuk ka informacion mbi ngarkesën mësimore të stafit të këtij programi në total duke përfshirë angazhimin e tyre në të gjithë programet që ofron ky Institucion.</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Burimeve njerëzore, disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program e të personave përgjegjës për organizimin e programit, nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Listës së plotë të PAE/PAK b. Listës së plotë të personelit ndihmës mësimor-shkencor c. Personelit administrativ. <p>Thirrjet për rekrutimin e personelit akademik publikohen në Qershor e Shtator të çdo viti kalendarik (pra në fund e në fillim të atij akademik).</p> <p>Titullarët e angazhuar të lëndëve rezultojnë të kenë së paku gradën shkencore Doktor.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Stafi pedagogjik i këtij programi është i kualifikuar, me eksperiencë dhe me gradat shkencore të kërkuara për një program Masteri profesional. Programi nuk ka PAK. Sugjerohet që për disa lëndë specifike, të merren edhe pedagogë me kontratë, ndoshta të punësuar në Administratën Publike kombëtare, të cilët mund të sjellin eksperiencën e tyre të terrenit ose fushat e tyre të ekspertizës në këtë Master. 2. Institucioni duket se e realizon më së miri moton e tij të “Studentit në qendër”. Në këtë funksion duket se është edhe interesi i Institucionit për të rritur cilësinë, jo vetëm të kërkimit shkencor, por edhe të mësimdhënies. Sistemi i tutoratit duket tejet efektiv dhe efikas, dhe studentët dukeshin të kënaqur prej tij. Raporti tutor/student është përafërsisht 1/10 për këtë program, ata kanë nga një udhëheqës për temën dhe një mbikëqyrës për praktikat profesionale. 3. Institucioni nuk jep informacion mbi ngarkesën mësimore të stafit të këtij programi (të numrit minimal dhe maksimal të orëve) që ata janë të angazhuar në total në Institucion. 	
<p>Standartet përmbushen</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mjediset mësimore të ofruara nga IAL-ja janë bashkëkohore, të rehatshme e shumëfunktionale. Teknologjitë e informacionit, infrastruktura, biblioteka e shërbime të tjera për studentët janë në funksion



të tyre e të ofrimit të një shërbimi cilësor në mësimdhënie. Studentëve iu vihet në dispozicion laborator i informatikës dhe sistemi audio-viziv në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare. Ndërtesa ka hapësira të bollshme relaksi si dhe rampa për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar. Ekzistojnë 6 salla për leksion, 15 salla për seminare, 1 sallë për aktivitet promovues, 1 për praktikë mësimore, 3 laboratorë informatike, salla interneti, biblioteke etj. Ka ambiente çlodhëse e me ajër të kondicionuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione (6 me kapacitet 100-120 vende)
- Klasa për seminare (15 me 30-45 vende)
- Salla për aktivitete promovuese (1)
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale (1)
- Laboratorë për lëndët (N/A)
- Laboratorë informatike (3)
- Salla interneti (1)
- Salla për bibliotekë (3)
- Mjedis për fotokopjime, librari etj (1)
- Zyrë informacioni për studentët (1)
- Nyje hidrosanitare (4-5)

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin (2)
- Zyra për sekretarinë mësimore (1)
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore (3)
- Zyra për personelin akademik (7)
-

Gjendja e godinës e konstatuar në institucion, përgjithësisht përputhet me atë të pasqyruar në RVB dhe këtu sa më sipër.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	



<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka vendndodhje të përhershme. Këto mjedise janë të marra me qira nga institucioni për jo më pak se 5 vjet. Programi i studimit ofrohet i gjithi në një godinë. Institucioni siguron menaxhim efikas në lidhje me këtë program. Institucioni garanton kryerjen e praktikave në këtë program studimi. Nga takimi që realzuar me studentët na u tha se pjesa më e madhe e tyre ishin të punësuar dhe praktikant i realizonin në vendin e punës.</p>
---	--

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucionin ka siguruar një literaturë të pasur përsa i përket nevojave të studentit dhe atyre të pedagogëve për kërkimin shkencor. Tekstet bazë në shqip ndodhen në bibliotekë në një sasi të konsiderueshme. Gjithashtu, në UMSH ofrohet edhe mundësia për akses në bibliotekën online Questia si edhe në Revistën e përjavshme The Economist. Biblioteka furnizohet rregullisht me tituj të rinj, sipas kërkesave të pedagogëve. Orari i mundësisë për të aksesuar në bibliotekë është i afishuar dhe në përputhje me kohëzgjatjen e orarit në të cilin UMSH-ja rezulton i hapur për publikun.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Institucioni vendos në dispozicion të studentëve të gjithë ambjentet e tij, të përshtatura në këtë drejtim. Laboratori informatik iu shërben studentëve në kryerjen më së miri të detyrave të kursit dhe të nevojave të tjera didaktike që ata mund të kenë. Kompiuterat në këtë laborator disponojnë software-ët e nevojshëm për këto funksione. Institucioni e ka zgjidhur më së miri çështjen e praktikave profesionale, duke i trajnuar më parë studentët në ambjentet e tij nëpërmjet zyrës së punës Headhunter çdo ditë të premtë të semestrit të dytë, e më pas duke i dërguar në instucione të tjera me të cilët ka bashkëpunime në këtë drejtim. IAL zhvillon çdo vit aktivitetin “Panairi i ideve” ku studentët paraqesin punët dhe idetë e tyre në këtë aktivitet.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. UMSH-ja duket të jetë një institucion i një niveli të kënaqshëm përsa i përket asaj çka i ofrohet studentëve dhe stafit akademik e atij professional që operon aty.
2. Laboratori informatik i standarteve të duhura teknike, biblioteka me mbi 4000 tituj librash të cilët shtohen në çdo vit akademik, aktivitetet në funksion të studentëve dhe mbështetja e vazhdueshme e

stafit akademik për rritjen e tij profesionale, duket se janë disa vektorë të cilët konvergojnë në një drejtim të përbashkët: atë të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e shtimit të numrit të studentëve.

Standartet përmbushen

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti ‘Mesdhetar i Shqipërisë’ funksionin si një program i një Organizate jo-fitimprurëse, me emrin ‘Qendra e Mesdheut’. Burimet e financimit presupozohet të vijnë prej kësaj Qendre, por ato vijnë realisht prej tarifës së studentëve (pjesa kryesore), aktiviteteve tregtare në brendësi të UMSH-së dhe konsulencave apo granteve.

Për këtë arsye, kosto për student ka qenë relativisht e ulët në krahasim me IAL-të e tjera jo publike dhe është për t'u përmendur fakti se një kategori e konsiderueshme studentësh trajtohen me bursë. Gjatë takimit të GVJ me përfaqësuesit e burimeve njërezore, ju pohua se 80% e studentëve marrin bursë të plorë dhe/ose të pjesshme ndërsa 20% paguajnë tarifën e plotë. Studentëve të cilëve ju ofrohet bursa janë të kategorive:

- Studentë të ekselencës
- Grupet e marginalizuara
- Studentët me nevoja të veçanta
- Studentët me probleme ekonomike

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
 - Grantet për kërkim(3%)
 - Konsulencat, shërbimet(N/A)
 - Tarifat për dhe gjatë shkollimit(87%)
 - Sponsorizimet(N/A)
 - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)(N/A)
 - Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj(N/A)
 - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)(10%)

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja për student në UMSH ka ndryshuar ndër vite, duke arritur në 137.000 lekë në këtë vitin e fundit. Pavarësisht kësaj kostoje të lartë, IAL-ja ja del të ofrojë disa bursa për studentët dhe të ketë tarifa konkurruese për regjistrimin e studentëve.

Në këto kushte, mund të thuhet se kapacitetet menaxhuese të Universitetit në këtë drejtim janë relativisht të kënaqshme. Ato do të duhet të specializohen më tepër, duke pasur si qëllim rritjen e financimit prej donatorëve dhe programeve/projekteve, në mënyrë që të justifikohet statusi jofitimprurës i kësaj IAL-je.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Siç u tha dhe më sipër, **rezultojnë të ketë një kontradiktë përmes statusit si jofitimprurës të Universitetit dhe mbështetjen e tij, prej mbi 87% ekskluzivisht në tarifatat e studentëve.**

Zyra për Kontabilitet dhe Financë është përgjegjëse për aktivitetin financiar dhe menaxhimin e fondeve në këtë IAL. Aktiviteti i saj auditohet për çdo vit si së brendshmi, ashtu edhe së jashtmi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Kontrolli i auditimit të brendshëm në UMSH realizohet nga njësi e auditimit të brendshëm e institucionit. Në bazë të rregullores së brendshme të IAL-së, njësi miratohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij. Raporti i auditit është i përvitshëm dhe rezultojnë në një pasqyrë të qartë të ardhurave të IAL-së.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj. Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Institucioni garanton një raport financiar për të gjitha vitet që prej krijimit të tij. Ai ka arritur të ulë kostot e regjistrimit për student ndër vite, duke dëshmuar jo vetëm një qëndrueshmëri financiare, por edhe një mirëmenaxhim të të ardhurave (kryesisht të tarifave të studentëve). Universiteti mbështetet nga OJF-ja “Qendra e Medheut” si edhe nga disa aktivitete tregëtare në brendësi të tij. Kapaciteti i tij financiar për gjenerimin e të ardhurave ka shumë potencial, një potencial i cili duhet të shfrytëzohet më mirë në të ardhmen.
Konkluzionet e vlerësimit:	
Sipas raporteve të paraqitura nga Zyra e Kontabilitetit dhe Financës ndër vite, rezultojnë se të ardhurat e IAL-së bazohen në: <ul style="list-style-type: none">• Grantet për kërkim (3%)• Tarifatat për dhe gjatë shkollimit (87%)• Aktivitetet tregëtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj) (10%) Në këto kushte, rekomandohet që të ardhurat të diversifikohen dhe të rriten ato nëpërmjet donacioneve (publikë/privatë), granteve për kërkim (nga stafi i pedagogëve i punësuar) si edhe ato nga projekte e marrëveshje bashkëpunimi, në mënyrë që të justifikohet statusi jo fitimprurës i këtij Universiteti dhe të justifikohet ulja e tarifave të regjistrimit dhe bursat e dhëna studentëve.	
Standardet përmbushen.	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ konstatoi se Cilësia e brendshme sigurohet nëpërmjet dy njësive kryesore:

- a. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave
- b. Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë

Këto dy njësi e kanë nisur punën si grupe ad hoc në fillimet e tyre, për t'u kthyer më pas në njësi të mirëfillta që prej vitit 2011. Është realizuar një Manual i Njësisë së Sigurimit të brendshëm të cilësisë, i cili iu vjen në punë njësive përgjegjëse.

Ndërkohë që NJSBCZHK-ja merret me sigurimin edhe të cilësisë së mësimdhënies, ajo e KSBC-së është e fokusuar kryesisht në rritjen e performancës akademike për stafin e pedagogëve me kontratë.

Për këtë qëllim, ajo ndërthur forma të vetëvlerësimit me ato të vlerësimit të jashtëm, në mënyrë periodike.

Të dhënat për anëtarët e NJSBC dhe NJSBCZHK janë dhënë në Aneksë tabela 6

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

Kryhen 2 anketime në çdo vit akademik me studentët.

- Sa studentë janë anketuar

Anketimi shkon në mbi 60% të studentëve të një kursi/lënde.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Përpunohen vetëm ato anketime ku numri i të anketuarve kalon 25% të frekuentuesve të rregullt të lëndës/kursit.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Anketimet e përpunuara, së bashku me raportin e vetëvlerësimit, i kalojnë Deaknit dhe ai zhvillon më tej takime të mbyllura me stafin.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBC informon në mënyrë periodike Dekanatin, Rektoratin mbi rezultatin e përpunimit të anketimeve dhe raportit të vetëvlerësimit të stafit. Ballafaqimi mes këtyre hallkave shkon në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe performancës së stadi, nëpërmjet takimeve kokë më kokë ku stafi këshillohet se si të arrijë rezultatin e dëshiruar.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Në nivel Departamenti, siguri i cilësisë përqendrohet në hartimin e kurrikulave bashkëkohore e të përditësuara si edhe në zhvillimin korrekt të leksionit e seminareve.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimi, rezulton të jetë hera herës tepër modest ose tepër i ekzagjeruar. Në këtë kuadër, drejtuesit e NJSBC-së rreken të verifikojnë punën shkencore/akademike të stafit e t'i bashkëngjisin asaj vlerësimet e studentëve e të Këshillit studentor.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
Nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit në mënyrë periodike, pedagogu jo vetëm që mat në mënyrë të kufizuar impaktin e punës së tij, por njëkohësisht edhe ndërgjegjësohet mbi punën dhe performancën e tij. Nëpërmjet këtij vetë-ndërgjegjësimi, synohet përmirësimi i punës së pedagogut dhe niveli i performancës në kërkimin shkencor.

NJSBC-ja rezulton të funksionojë në mënyrë shumë efektive, duke ruajtur privatësinë, por edhe duke nxitur për përmirësim.

Puna pozitive e NJSBC-së u evidentua edhe në Institucion, përgjatë vizitës aty.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Në institucion na u tregua një model formulari vetëvlerësimi, një model pyetësori i studentit, një përlllogaritje e performancës të pedagogëve nëpërmjet tabelës së pikëzimit si edhe një raport vjetor i NJSBCZHK-së.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; 	<p>Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e përvitshëm të punës së tij, nëpërmjet metodave të tërthorta e të drejtpërdrejta.</p> <p>Të gjithë këto elementë, përfshihen në Raportin vjetor të NJSBCZHK-së, i cili iu dërgohet Dekanëve përkatës dhe Rektorit.</p> <p>Pas kësaj, ata ia referojnë pedagogëve pikëzimin përkatës dhe publikojnë rezultatet e përgjithshme që kërkohet të arrihen.</p> <p>NJSBC-ja përpiket, përgjatë të gjithë vitit të ardhshëm akademik, të realizojë të gjithë rekomandimet e evidentuara nga Raporti.</p> <p>Duhet thënë se metodat e tërthorta janë më së shumti të pranishme, në krahasim me ato të drejtpërdrejta, në respekt të ruajtjes së privatësisë të profesionit të respektuar të pedagogut.</p>

<p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Institucioni publikon rregullisht broshura dhe buletine për vlerësimin e brendshëm. Disa prej tyre na u vunë në dispozicion përgjatë vizitës. Web-i i institucionit është aktiv, po ashtu edhe faqet në rrjetet sociale. Nuk kemi informacione në lidhje me këto publikime.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Institucioni harton politika zhvillimore që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni i ka plotësuar standartet institucionale, sidomos pas akreditimit të brendshëm të realizuar përgjatë vitit akademik 2017.</p> <p>Zyra e NJSBCZHK-së dhe ajo e NJSBC-së janë aktive përgjatë të gjithë vitit akademik nëpërmjet monitorimit, mbikëqyrjes, sugjerimeve për përmirësimin e kurrikulave dhe të planeve mësimore.</p> <p>Si rrjedhojë e kësaj punë, IAL-ja ka arritur të ketë një manual të Sigurisë së Cilësisë dhe t'ë aplikojë gjetjet kryesor të tij përgjatë rregulloreve të brendshme.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<p>1. IAL-ja i kushton një vëmendje të veçantë sigurimit të cilësisë në çdo hallkë të kësaj sigurie, duke filluar që prej:</p> <ol style="list-style-type: none"> Konsolidimit në dy njësi të veçanta të NJSBCZHK-së dhe NJSBC-së Rakordimit të monitorimit, anketimin e vlerësimit të brendshëm në një raport vjetor të përgjithshëm për tërë institucionin Punës së përhershme për arritjen e objektivave të këtij raporti 	

- d. Hartimin e manualeve të cilët e lehtësojnë këtë proces
- e. Hartimit të strategjive të zhvillimit të Institucionit.

Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie shumëfunktionale, standartet rezultojnë të përmbushura.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me tre profile është licensuar prej Urdhërit të Ministrit të Arsimit Nr. 482, datë 3.10. 2011, ku specifikohet se ky program duhet të zgjasë 1.5 vite dhe duhet të ketë 90 kredite. Por ky program është ofruar me 60 kredite nga UMSH. Megjithatë, ky ndryshim është në përputhje legjisacionin në fuqi, siç konfirmohet nga Shkresa nr. 2749/1, datë 24.4.2018 e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative është ofruar duke u bazuar në eksperiencën e UMSH, si dhe nevojën e tregut të punës në Shqipëri. Ky master formon politologë, administratorë dhe funksionarë publikë. Ky program synon që, duke theksuar lëndët me karakter praktik, të aftësojë studentët për t'u përfshirë në aktivitete konkrete të administrimit politik dhe publik. Masteri ka karakter të fortë profesional për të krijuar njohuritë bazë dhe të aplikuara të profesionit të politologut ose të kërkuesit politik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi


Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profile Administratë Publike, Qeverisje Vendore, Politikat Sociale është hapur në vitin 2011 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 482, date 03.10.2011. Qëllimet e programit janë të përgatisë politologë, funksionarë publikë dhe administratorë të aftë për të kontribuar në zhvillimin e vendit. Objektivat fokusohen te përgatitja e kapaciteteve njerëzore, ekspertëve dhe analistëve të shkencave politike dhe administratës publike.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- o 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- o 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Planin mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:



- Për leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret/Ushtrime 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret/Detyra 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Plani mësimor nuk ka pësuar ndryshime në krahasim me programin mësimor të licensuar.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Personeli akademik i angazhuar për të zhvilluar lëndët e programit të studimit zotëron gradat shkencore të duhura për këtë qëllim, me përjashtim të një rasti kur titullar lënde është një person me Msc. Në këtë program studimi ka 3 Prof. Asoc. Dr, 2 PhD, 1 Dr, 1 PhD (c) dhe 1 Msc.

40 përqind e lëndëve zhvillohet nga pedagoge femra, duke ruajtur në këtë mënyrë edhe balancat gjinore.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e këtij programi studimi janë të standardizuara sipas një formati të përshtatshëm, i cili paraqet të gjithë elementët e qenësishëm të lëndës, që nga përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, kreditet dhe ngarkesa, emërtimi i detajuar i temave, literatura e kërkuar, e ndarë në të detyruar dhe ndihmëse, e deri te forma e kontrollit të njohurive. Literatura e syllabuseve është e kohëve të fundit dhe relevante për lëndët. Pedagogët përgjegjës kanë ekspertizën e duhur për lëndët që ofrojnë. Kjo ndihmohet edhe nga fakti që 3 prej tyre janë Prof. Asoc. Dr, 2 janë PhD dhe 1 është Dr. Vetëm një pedagog është titullar në më shumë se sa një syllabus. Ai është titullar në 3 syllabuse dhe ka gradën Prof. Asoc. Dr. Megjithatë, fakti që ky pedagog është titullar në 3 syllabuse nuk përbën problem, pasi studentët e cilitdo nga profilet e programit të studimit zhvillojnë vetëm 2 lëndë me të.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Shkolla e lartë private “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” si institucion dhe programet e studimit për të cilat ka lëshuar diplomë janë të akredituara prej Këshillit të Akreditimit me Vendimin nr. 256, datë 16.9.2011.</p> <p>Aktualisht institucioni mban statusin Universitet.</p> <p>Programet janë të organizuara në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave.</p> <p>Programi ofrohet me kohë të plotë.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Ky program studimi i përmbush më së miri kriteret e vendosura, pasi ofron njohuri të thelluara praktike dhe profesionale, të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e punës. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, duke bërë një përsëritje të shpejtë të nocioneve bazë për të akomoduar edhe avancimin e studentëve që nuk kanë përfunduar studimet bachelor në këtë fushë.</p> <p>Theks i veçantë është vënë tek praktika profesionale dhe punimi i diplomës që në rastin e këtij programi kërkohet të jetë me natyrë aplikative. Objektivat e programit janë profesionalë dhe të qartë, duke synuar përputhjen me kërkesat e tregut të punës.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare</p>	<p>Niveli i studimeve respektohet nga ky program studimi, gjë që shihet te përmbajtja dhe renditja e objektivave sipas një logjike të përshtatshme. Kjo dëshkohet edhe prej metodave të vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të</p>

dëshmojnë ecurinë dhe arrijtjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	njohurive, por edhe prej intervistave me ta në Institucion.
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve evropiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	Programi është hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore evropiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arrijtjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve realizohet jo vetëm përmes praktikës profesionale, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikativ që ofrohen në programin e studimit. Edhe aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodologjisë, seancave metodologjike për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UMSH dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	Programi trajton çështje të reja por shumë të rëndësishme në zhvillimet e shkencave politike si profesion në dekadat e fundit. Për këtë arsye stafi akademik i programit është i angazhuar në përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive për t’iu përshtatur kërkesave në rritje të tregut të punës.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Gjatë vizitës në UMSH, GVJ ju komunikua se: Gjatë hartimit të programit të studimit janë zhvilluar konsultime nga UMSH me përfaqësues të rëndësishëm të tregut të punës dhe institucione shtetërore. Rekomandimet e tyre pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.</p> <p>Duke qenë se edhe vetë studentët që ndjekin studimet në këtë program janë të punësuar, mendimi i tyre ka një rëndësi të madhe në këtë drejtim.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program studimi nuk bie ndesh aspak me interesat kombëtare. Përkundrazi, ai synon zhvillimin e tyre dhe ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Kohëzgjatja dhe numri i krediteve të programit MP Shkenca Politike dhe Administrative me tre profile janë në përputhje me kërkesat ligjore.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentët njihen në kohën e duhur me syllabusin, informohen me anë të broshurave të printuara, sekretarisë, emailit personal etj për element të ndryshëm të programit të studimeve.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Plani i diplomimit është i parashikuar qartë te plani mësimor, ku lëndët janë organizuar në atë mënyrë që të mundësohet diplomimi pas marrjes së 60 krediteve brenda 1 viti akademik.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UMSH e ofron programin e studimit MP në Shkenca Politike dhe Administrative me tre profile në përputhje me misionin dhe qëllimin e vet dhe konform legjislacionit në fuqi. 2. Ky program studimi është i detajuar dhe informues; ai vendos një theks të veçantë te aspektet praktike dhe aplikative. <p>Sa më sipër dëshmon se programi i studimit MP në Shkenca Politike dhe Administrative me tre profile i përmbush standardet.</p>	

8.Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

Mësimdhënia organizohet sipas lëndëve specifike të programit të studimit, duke mbajtur në konsideratë ekspertizën dhe ngarkesën e stafit pedagogjik gjatë vitit akademik. Mësimi zhvillohet në formë leksioni, seminari, praktike profesionale dhe konsultimi. Ngarkesa mësimore ndahet sipas një norme të përcaktuar nga IAL për secilin pedagog. Lidhur me cilësinë e realizimit të ngarkesës mësimore, IAL e ka vlerësuar procesin rast pas rasti. Metodat e mësimdhënies të përdorura në leksione dhe seminare janë përgjithësisht të pasura dhe angazhuese për studentin, që nga brainstorm e deri te diskutime dhe debate

në klasë. Për të vlerësuar së brendshmi mësimdhënien IAL ka angazhuar disa struktura për ndjekur orët e mësimi, por gjithashtu ka marrë opinione dhe sugjerime nga studentë dhe pedagogë për lëndët.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

- Leksione
- Seminare
- Praktikë profesionale
- Etj

Tabela më poshtë paraqet ngarkesën totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit

Programi i Studimit MP në Shkenca Politike dhe Administrative	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	285
Seminare	210
Ushtrime	
Laboratore	
Praktikë lëndore	
Praktikë profesionale	105
Etj	25
Në total	625

Format e kontrollit të njohurive

Për kontrollin e njohurive i kushtohet rëndësi pjesëmarrjes aktive gjatë ndjekjes së lëndës (10%), plotësimi të detyrimeve të llojit detyrë kursi (10%), testeve gjatë vitit (20%) dhe provimit përfundimtar (60%).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët janë angazhuar në projekte shkencore në rang Fakulteti në numër të konsiderueshëm, 46 studentë. Aktivizime të tjera të studentëve në projekte shkencore në rang Departamenti, në punimet individuale të pedagogëve dhe në bashkëpunim me të tjerë nuk raportohen.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Lidhur me treguesit e mësimdhënies si llojet e formave të saj, format e kontrollit të njohurive dhe aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, të dhënat e deklaruara nga IAL në DVV përkojnë me gjendjen e konstatuar gjatë vizitës në IAL.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kriteret akademike dhe procedurat e pranimit të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu pranimi i studentëve është konform rregullores së programit të studimit, ku specifikohet se pranohen të gjithë ata studentë që kanë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 ECTS. Për kriteret dhe procedurën e aplikimit gjen informacion te faqja zyrtare e UMSH, në broshura informuese dhe në media. Raporti numerik student – pedagog është i përshtatshëm si premisë për arsimim cilësor të studentëve. Kështu garantohet përkujdesja gjatë procesit mësimor dhe zhvillimi efektiv i aktiviteteve jashtëshkollore. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) ka rol thelbësor për t’i mbështetur studentët gjatë kohëzgjatjes së studimeve, duke i orientuar të marrin pjesë në projekte, programe dhe konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare. Po ashtu ZKSK mban kontakte të rregullta me ish-studentët e diplomuar, mbledh të dhëna për ta, karrierën dhe punësimin e tyre sipas çdo programi studimi.

Aktualisht, për vitin akademik 2017-2018, këtë program studimi e ndjekin 6 studentë nga profili Administrim publik dhe 3 studentw nga Politika Sociale. Nga të dhënat e paraqitura në RVB ka një pasaktësi me numrin e studentëve. Për vitin 2017-2018 paraqiten 26 studentë. Nëse i referohemi të dhënave të sjella nga institucioni si dokumentacion pas kryerjes së vizitës së GVJ, për numrin e studentëve për vitin 2018-2018 në këtë program studimi, specifikohet se numri i tyre është 6 studentë nga të cilët 7 janë me bursë.

Numri i studentëve ka ardhur duke u rritur, sidomos në vitin akademik 2014-2015, ku kemi të bëjmë me një boom regjistrimesh në këtë Master për shkak të Reformës administrative. Cilësia e studentëve në këtë Master ka ardhur duke u rritur, gjithashtu edhe cilësia e tyre në hyrje/dalje ka qenë në avantazh të kësaj të fundit.

Tabela me të dhëna për regjistrimin e studentëve

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)
		Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2011-2012	14	0						0	14
2012-2013	10	2						2	12
2013-2014	21	5						5	26
2014-2015	45	7						7	52
2015-2016	40	7						7	47
2016-2017	26	5	1					6	32
2017-2018	26	0						0	26

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve në programin e studimit MP në Shkenca Politike dhe Administrative janë transparente për studentët, në përputhje me kriteret ligjore dhe ofrojnë lehtësinë e duhur për t’u bërë pjesë e komunitetit të studentëve të UMSH. Kriteret e vendosura janë në respekt të ligjit dhe rregulloreve të brendshme të IAL, nevojave të tregut dhe mundësive akademike dhe infrastrukturore të IAL. Lidhur me sa më sipër, reagimi i studentëve është pozitiv.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia e studentëve në hyrje është ruajtur përgjatë viteve, pavarësisht oshilacioneve të vogla. Nota mesatare në hyrje ka variuar nga 8.8 më e larta deri te 6.7 më e ulta. Lidhur me notën mesatare të studentëve në dalje IAL nuk ka dhënë informacion.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Nota mesatare e studentëve të regjistruar në vitin e parë për herë të parë ka qenë e kënaqshme, mesatarisht te nota 7.5, duke garantuar kështu cilësinë e duhur nga ana e studentëve për zhvillimin e programit të studimit.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

IAL nuk ka dhënë informacion për këtë.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

UMSH njih kreditet dhe transferon studimet midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda të njëjtit institucion ashtu dhe ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimesh dhe në fusha studimesh të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Nga 84 studentë të diplomuar në këtë program studimi, 61 studentë janë punësuar në përputhje me diplomën e marrë dhe 14 studentë janë punësuar jo në përputhje me diplomën, ndërkohë që 9 studentë nuk janë punësuar.

- Numri total të diplomuarve

Numri total i studentëve të diplomuar në këtë program studimi që prej hapjes së tij është 84.

- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën është 61.

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën është 14.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Pranimi është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Veç kësaj, studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga universiteti.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në	Në përputhje me udhëzimin e MAS mbi nivelin e gjuhës së huaj, studentët nuk e kanë detyrim që në pranimin e tyre në



<p>Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>këtë program studimi të paraqesin një dëshmi për njohjen e një prej 5 gjuhëve të BE-së., të parashikuar anë Udhëzimin e MASR</p> <p>Universiteti vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>ZKSK në UMSH është zyra thelbësore për informimin e studentëve lidhur me programin e studimit dhe elementë të tjerë të studimeve të tyre. Informacioni që marrin studentët është mjaft i detajuar. Studentët kanë gjithashtu mundësinë të vlerësojnë pedagogun e secilës lëndë në fund të semestrit, në një kohë të përshtatshme, për të siguruar objektivitetin e vlerësimit. Ata mban gjithashtu të informuar për mundësitë për punësim pas diplomimit.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në këtë program, për notën mesatare në hyrje, për transferimet e studentëve, për tërheqjet dhe largimet para përfundimit të programit.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me sekretarinë mësimore është i informuar mbi ecurinë e studentëve.</p> <p>Këto të dhëna GVJ ju komunikuan gjatë takimit në Sekretarinë mësimore</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>UMSH ofron këshillim karriere për studentët dhe gjithashtu organizon tutoriate për t’i ndihmuar me mbarëvajtjen e procesit mësimor. ZKSK i ndihmon studentët të përzgjedhin institucionin e praktikës profesionale.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve. Në rast mosmarrëveshjes apo konfliktesh, studentët bisedojnë me pedagogun e lëndës. Nuk ka pasur raste përplasjes apo konfliktesh në këtë drejtim, pasi ato janë zgjidhur gjithnjë me marrëveshje mes palëve.</p>
---	--

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>UMSH ofron këshillim karriere për studentët dhe gjithashtu organizon tutoriate për t'i ndihmuar me mbarëvajtjen e procesit mësimor. ZKSK i ndihmon studentët të përzgjedhin institucionin e praktikës profesionale.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Studentët ndjehen të mirëpritur në UMSH dhe të drejtat e tyre gjejnë zbatim.
2. Studentët informohen hollësisht dhe në kohën e duhur për politikën e punësimit.
3. UMSH disponon të dhëna për numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit. Vërehet se të dhënat ndonjëherë janë kontradiktore (26 studentë në RVB apo 6 studentë sipas dokumentacionit të paraqitur po nga UMSH)
4. Ekziston fryma, por edhe strukturat e përshtatshme për kujdesin ndaj studentëve.
5. IAL duhet të japë informacion për notën mesatare në dalje të studentëve në këtë program studimi, sikurse dhe për notën mesatare të studentëve të diplomuar në vitin e fundit.

Standardet përmbushen kryesisht.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikën e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësi, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Gjatë takimeve si me drejtuesit e Institucionit pr edhe me stafin akademik, GVJ u njoh me puënn kërkimore të këtij stafi. Për arsye të karakterit profesional të këtij programi, përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor është pak e vështirë, pasi nuk është detyrim. GVJ ju pohua se për UMSH, kërkimi shkencor, inovacioni dhe mobiliteti i stafit janë një gur themeli dhe pjesë kryesore e strategjisë së zhvillimit institucional. Për të ndërmarrë kërkim shkencor në nivelin më të lartë dhe të orientuar drejt politikave publike, UMSH bazohej në gamën e gjerë të ekspertizës që zotëron. Ky institucion nxiste vizitat studimore dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore të personelit akademik duke synuar

njëkohësisht ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor. Gjithashtu UMSH, edhe në këtë program studimi, udhëhiqet nga ideja se kërkimi shkencor duhet t'i shërbejë tregut. Për këtë arsye preferohen dhe stimulohen studime shkencore me vlerë aplikative dhe me rëndësi për vendimarrjen politike, publike dhe administrative. Po ashtu bëhen përpjekje të konsiderueshme për ta lidhur kërkimin shkencor të pedagogëve me procesin e mësimdhënies sipas lëndëve përkatëse. Në funksion të kërkimit shkencor UMSH boton revistën shkencore EUROMEDITERRANEAN, ku pranohen artikuj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Këshilli shkencor i këtij programi studimi ka në përbërje të tij 3 Prof. As nga të cilët një është Drejtues dhe dy janë Anëtarë. Në Anekse paraqiten të dhënat për Këshillin shkencor, emër mbiemër, titulli/grada dhe funksioni i tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

UMSH ka një numër të lartë botimesh shkencore të personelit akademik, 949, dhe 532 pjesëmarrës në aktivitetet shkencore të organizuara nga Institucioni. Është për t'u vlerësuar fakti që ka marrë gjithashtu 2 çmime kombëtare në kërkimin shkencor. Megjithatë duhet rritur numri i projekteve kërkimore të fituara, i cili është 3.

Tabela më poshtë paraqet të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	949
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	3
3.	Numri i projekteve të zbatuara	3
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit	7
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	532
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	3
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	174
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	2

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik publikon rregullisht artikuj shkencorë në disiplinën përkatëse, në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Nëpërmjet angazhimit në këto veprimtari ndihmohet zhvillimi i prodhimit shkencor, ndërsa në raste të tjera, kur nuk bëhet fjalë për artikull shkencor por për policy paper, veprimtaria vihet në funksion të vendimarrjes dhe përmirësimit të shërbimit.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Në këtë institucion nuk ofrohet asnjë program studimi apo lëndë në gjuhën angleze.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UMSH organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor, të tilla si trajnime në pedagogji dhe metodologji shkencore. UMSH i ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>UMSH disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, e cila hartohet në bazë të deklarimeve individuale të personelit akademik. IAL disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; UMSH disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MP në Shkenca Politike dhe Administrative.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>1. Vihet re që tre nga katër standardet plotësohen në këtë program studimi.</p> <p>a) Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore si publikimi i artikujve dhe materialeve shkencore që janë relevante për programin e studimit.</p> <p>b) Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit akademik realizohet periodikisht me fokus të veçantë në çështjet e pedagogjisë dhe metodologjisë shkencore.</p> <p>c) Veprimtaria kërkimore-shkencore e personelit akademik është e monitoruar dhe regjistruar në një bazë të dhënash që disponohet nga Universiteti.</p> <p>Standardet përmbushen.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun
Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Gjatë vizitës në Institucion, si dhe gjatë shqyrtimit të RVB, konstatojmë se: UMSH ka bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar të gjerë. Ai është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe i EURAS. UMSH ka nënshkruar të paktën 50 marrëveshje bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe jo arsimore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Të shumta dhe të efektshme janë lidhjet që UMSH ka krijuar me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës. Këto lidhje përdoren për të realizuar praktikat profesionale të studentëve, për t'u ofruar mundësi punësimi studentëve, por edhe për të ofruar konsulencë në fusha ku UMSH zotëron ekspertizë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Bashkëpunimi i gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar konfirmohet nga fakti që UMSH ka patur 23 partnerë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirja e lektorëve të huaj (218 orë mësimore) dhe numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL ose jashtë vendit (120).

Të dhëna për Institucionet bashkëpunuese dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare gjenden në anekse tabela 13 dhe 14

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

UMSH ka një bashkëpunim shumë të gjerë dhe të shumëllojshëm me institucione shtetërore, organizata profesionale, me shoqata biznesi dhe kompani specifike dhe me aktorë të tjerë të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të arsimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>UMSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit, duke garantuar përmes shërbimeve të konsulencës që u ofron, realizimin e praktikave të studentëve.</p> <p>Përveç dërgimit në institucione/kompani ku ekzistojnë marrëveshjeve dypalëshe të cilat gjenden në fund të RVJ-së, institucioni bashkëpunon me kompaninë e njohur të rekrutimit të burimeve njerëzore Headhunter dhe nëpërmjet kësaj kompanie studentët dërgohen në Institucione/kompani të ndryshme ku mund të ketë nevojë për praktikantë.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>IAL synon shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit në funksion të hartimit dhe mbikëqyrjes së programit të studimit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen në atë mënyrë që bashkëpunimi të jetë i frytshëm.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UMSH karakterizohet nga një gamë e gjerë bashkëpunimi me aktorë vendas dhe të huaj, të cilët janë relevantë direkt ose indirekt për sektorin e arsimit të lartë. UMSH organizon trajnime profesionale për studentët dhe komunikon intensivisht me punëdhënësit për të shqyrtuar mundësitë e punësimit të tyre. UMSH bën një raport për të analizuar përfitimet e ardhura nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimeve.</p>
